



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 nëntor 2022
Nr. Ref.:RK 2083/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI33/21

Parashtrues

Halim Vrellaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 236/2020, të 10 nëntorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Halim Vrellaku nga fshati Baicë, komuna e Glllogocit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Florent Latifaj, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. nr. 236/2020 të 10 nëntorit 2020, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 38/2020 të 13 marsit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. nr. 350/18 të 23 dhjetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 11 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 3 mars 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 27 tetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 korrik 2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti Aktakuzën (me numër PP/I. nr. 91/2014) kundër parashtruesit të kërkesës dhe personave të tjerë, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, përkatësisht për shkak të dyshimit të bazuar se në cilësinë e personave zyrtarë si rrjedhojë e mospërmbushjes së detyrave zyrtare kanë mundësuar ndërtimin e objekteve pa leje.
10. Më 30 gusht 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit (PKR. nr. 414/16), shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe H. Xh. T. për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, ndërsa H. Xh. T. i shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë veprë të re penale. Ndërsa personat e tjerë të përfshirë me Aktakuzën (me numër PP/I.

nr. 91/2014) i liroi nga akuza sepse nuk është vërtetuar se këta të pandehur kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

11. Më 13 tetor 2017, parashtruesi i kërkesës dhe H. Xh. T. paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (PKR. nr. 414/16) të Gjykatës Themelore të 30 gushtit 2017, për shkak të *“shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim”*.
12. Më 12 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit (PAKR. nr. 503/2017), aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe H. Xh. T. dhe anuloi pjesën e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në lidhje me parashtruesin e kërkesës dhe H. Xh. T. dhe e ktheu çështjen në të njëjtën gjykatë për rivendosje, ndërsa pjesën e mbetur të aktgjykimit në lidhje me personat e tjerë në këtë procedurë e vërtetoi në tërësi.
13. Më 8 maj 2018, Gjykata Themelore në procedurën e përsëritur, përmes Aktgjykimit (PKR. nr. 27/2018) e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe e gjykoj me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa të akuzuarën e dytë, H. Xh. T., e liroi nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar për shkak se nuk është vërtetuar se e pandehura ka kryer këtë vepër penale për të cilën akuzohet.
14. Në pjesën e arsytimit të Aktgjykimit që ka të bëjë me parashtruesin e kërkesës, Gjykata Themelore thekson se parashtruesi i kërkesës *“ishte emëruar në cilësi të inspektorit të ndërtimit në bazë të autorizimit të dhënë nga drejtoresha, dhe për çdo veprim e ka informuar drejtoreshën H. Xh. T. Në bazë të provave të propozuara nga pala dhe të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor vërtetohet se i njëjti në prill të vitit 2013 me autorizim ishte caktuar të ushtroj detyrën e inspektorit të ndërtimit, ndërsa i njëjti kah mesi i muajit qershor 2013 ishte vënë në dijeni se kishin filluar punimet në bllokun V. Ky fakt se i akuzuari ishte vënë në dijeni për fillimin e punimeve vërtetohet nga deklarata e të akuzuarit dhënë në shqyrtim gjyqësor se “nga mesi i muajit qershor të vitit 2013 kam dëgjuar se po ndërrohet izolimi ...”. Kurse i akuzuari në vendin e ngjarjes për të bërë inspektimin e punimeve del tek përafërsisht pas një muaji, përkundër asaj se për fillimin e punimeve kishte dëgjuar nga mesi i muajit qershor dhe faktit se ndërmjet objektit ndërtimor dhe Komunës së Drenasit nuk ekziston një largësi e madhe fakt ky që vërtetohet nga Skica e internetit që përshkruan objektin e Komunës së Drenasit dhe të objektit të ndërtimit pa leje në bllokun B, e cila është pjesë e shkresave të lëndës. Fakti se i akuzuari kishte bërë inspektimin e punimeve, tek pas një muaji vërtetohet nga procesverbali 002886 me nr. 351-11060 i dt. 10.07.2013, me të cilin procesverbal e ka obliguar investitorin që në afat prej 8 ditësh të pajiset me leje ndërtimi. Me këto prova vërtetohet fakti se i pandehuri Halim Vrellaku edhe pse e ka ditur se kanë filluar punimet, nuk ka ndërmarr veprimet që e obligon ligji në mënyrë që të bëjë inspektimin me të kuptuar se kanë filluar punimet”*.
15. Më 10 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (PKR. nr. 27/2018) të Gjykatës Themelore të 8 majit 2018, *“për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin”*.
16. Në një datë të pacaktuar, Prokuroria Themelore në Prishtinë gjithashtu paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (PKR. nr. 27/2018) të Gjykatës Themelore të 8 majit 2018, *“për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal”*, me propozimin që Gjykata e Apelit të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të sjellë aktgjykimin dënues për

- të akuzuarën H. Xh. T., si dhe të shqiptojë dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës.
17. Më 5 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 418/2018), refuzoi si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore lidhur me të akuzuarën e dytë H. Xh. T. dhe vërtetoi në tërësi këtë pjesë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Ndërsa sa i përket parashtruesit të kërkesës, ankesa e Prokurorisë Themelore është refuzuar si e pabazuar, dhe me këtë rast ankesa e parashtruesit të kërkesës është aprovuar, ndërsa pjesa e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore përkitazi me parashtruesin e kërkesës është anuluar dhe çështja i është kthyer gjykatës së njëjtë në rivendosje.
 18. Më 23 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë në procedurën e përsëritur nxori Aktgjykimin [PKR. nr. 350/2018], me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.
 19. Në pjesën relevante të arsyetimit të Aktgjykimit, Gjykata Themelore thekson se parashtruesi i kërkesës *“gjatë periudhës inkriminuese, si Inspektor i Ndërtimit sipas autorizimit, nuk ka përmbushur detyrën zyrtare, nuk ka ndërmarrë veprimet konkrete në kuadër të kompetencave të cilat rrjedhin nga Ligji për Ndërtimin, neni 34, par. 1 ku thuhet: “Gjatë inspektimit, inspeksioni ndërtimor mund të urdhëroj poseduesin e lejes ndërtimore të rrënoj objektin ndërtimor nëse është vërtetuar se ka parregullsi të riparueshme që rrezikojnë stabilitetin e ndërtimit, stabilitetin e ndërtimeve fqinje apo vë në rrezik jetën e personave”, në rastin konkret, autoriteti kompetent i cili merr vendime për rrënimin e objekteve të ndërtimit, në rast të mospërputhjes me kërkesat e lejes ndërtimore, apo në mungesë të lejes ndërtimore, është Inspektori i Ndërtimit. Elementi tjetër i veprës penale e cila është objekt i këtij shqyrtimi qëndron në atë se, duke mos i përmbushur detyrat e tij zyrtare në kuadër të autorizimit të tij si Inspektor i Ndërtimit, i ka mundësuar personit tjetër [...] që të përfitojë dobi pasurore ashtu që nga mbi ndërtimi i 14 banesave nën kulmin e Bllokut banesor nr. V, të ndërtuara në kundërshtim me Ligjin për Ndërtimin, duke i shitur disa nga to në vlerë prej [...], dhe duke e dëmtuar Komunën e Drenasit”.*
 20. Në arsyetimin e pjesës së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore që ka të bëjë me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me autorizimet e tij në rastin konkret, Gjykata Themelore thekson se, *“duke marrë parasysh se punimet në Objektin banesor nr. V, kishin filluar më dt. 08.06.2013, dhe se autorizimi për ushtrimin e funksionit të Inspektorit të Ndërtimit lëshuar nga Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës – KK Drenas, për të pandehurin ishte lëshuar nga data 19.04.2013 deri me dt. 18.07.2013, se lokacioni ku është kryer mbindërtimi në kulmin banesor nr. V gjendet në afërsi të Kuvendit Komunal në Drenas, atëherë i pandehuri si person përgjegjës për të ushtruar funksionet e Inspektorit të Ndërtimit, ka pasur mundësi dhe kompetencë ligjore që të ndërmarrë veprime konkrete për të ndaluar punimet e kundërligjshme në Bllokun banesor nr. V në Drenas, sepse i njëjti ishte në dijeni se me dt. 18.07.2013 do t'i skadojë mandati si Inspektor i Ndërtimit dhe një veprim të tillë nuk e ka ndërmarrë, dhe në këtë mënyrë investitorit [...] i ka mundësuar që punimet e kundërligjshme t'i vazhdojë duke ndërtuar 14 banesa në nën kulm të bllokut”.*
 21. Më 14 janar 2020, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (PKR. nr. 350/2018) të Gjykatës Themelore të 28 tetorit 2019, për shkak të *“vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe dënimit kundër të pandehurit dhe vendimit mbi dënimin”.*

22. Më 13 mars 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 38/2020) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se, *“përveç që ka qenë shef i inspeksionit, nga dt. 19.04.2013, e gjerë me dt. 18.07.2013, në bazë të një autorizimi të lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, ka kryer edhe detyrat e inspektorit të ndërtimitarisë, se gjatë kësaj periudhe ka qenë i njoftuar për ndërtimin pa leje gjegjësisht mbindërtimet, për çka edhe ka dalë në vendin e ngjarjes ku edhe ka përpiluar procesverbal mbi gjetjet që konstatuara në vendin e ngjarjes, gjegjësisht ndërtim jo të rregullt, për çka edhe ka urdhëruar ndërtuesin që në afat prej 8 ditësh, të bëjë plotësimin e dokumentacionit, ku për shkak të mosveprimit sipas urdhëresës së inspeksionit ka marrë edhe aktvendim për ndërprerjen e punëve, mirëpo, më tutje nuk ka vazhduar me aktvendimin tjetër për rrënim të objektit, [...], pavarësisht faktit se të akuzuarit me dt. 18.07.2013, i ka skaduar afati i autorizimit për kryerjen e punëve edhe të inspektorit të ndërtimit, i njëjti – pra i akuzuari ka qenë i autorizuar të kryej punët në fjalë që nga dt. 19.04.2013, ndërsa punë në ndërtimin pa leje kanë filluar me dt. 08.06.2013, pra gjatë kohës sa ka qenë i akuzuari inspektor i ndërtimit, i cili ka pranuar se e ka ditur për një gjë të tillë, gjë që rezulton se i akuzuari ka mundur të veproj menjëherë pasi ka kuptuar për ndërtimet pa leje, e jo të reagoj vetëm në 10 (dhjetë) ditëshin e fundit, kur edhe i ka skaduar autorizimi për kryerjen e punëve të inspektorit të ndërtimit, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë, pasi ka marrë parasysh edhe faktet kundërthënëse, ka aprovuar konkludimet në fjalë, e të cilat konkludime i aprovon edhe kjo gjykatë, prandaj, aktgjykimi i ankimuar edhe në këtë drejtim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 1, nën par. 12 të KPPK-së, sikur që pretendohet në ankesë”.*
23. Më 6 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të *“shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të Kodit të Procedurës Penale nga neni 384, paragrafi 1, pika 1.12 dhe neni 370 të këtij Kodi, dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor”.*
24. Më 10 nëntor 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pml. nr. 236/2020, refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilën ai e kishte paraqitur kundër Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të 13 marsit 2020 dhe Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të 28 tetorit 2019, duke arsyetuar se *“Gjykata Supreme konstaton se janë të vërteta të cekurat në kërkesë se në objektin në fjalë ka pasur nevojë për renovim të kulmit (sipas petitionit të banorëve të datës 30.05.2012), por në vend të rinovimit është bërë mbindërtimi pa leje, i cili ka filluar më datën 08.06.2013. Kjo i bie në periudhën kur i dënuari, sipas autorizimit, ka kryer punët e inspektorit të ndërtimit. Pa marrë parasysh se i dënuari, për shkak të afërsisë së objektit e ka kuptuar menjëherë se është nuk është fjalë për renovim por për mbindërtim, nuk ka intervenuar deri më datën 10.07.2013, kur për herë të parë i ka inspektuar punimet, që do të thotë pas më se një muaji. Nëse kësaj i shtohet afati 8 ditor të cilin ia ka caktuar kryesit të punës për ndërprerjen e ndërtimit, kuptohet se mu me skadimin e këtij afati, atij i ka skaduar statusi i inspektorit të ndërtimit. Për më tepër, aktvendimin për pezullimin e ndërtimit, i dënuari e ka marrë më datën 17.07.2013, sërish duke e lënë afatin 8 ditor, një ditë para skadimit të statusit të tij të inspektorit të ndërtimitarisë. Ajo për çka i dënuari është shpallur fajtor është mos ndërmarrja e veprimeve për të penguar këtë ndërtim, siç ceket edhe në dispozitivin edhe në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë, e me çka pajtohet edhe kjo gjykatë. Nuk mund të aprovohet pretendimi në kërkesë se i dënuari i ka ndërmarrë të gjitha veprimet në kuadër të kompetencave të veta, sepse ai nuk e ka penguar këtë ndërtim pa leje e as pretendimi se ai fare nuk ka qenë kompetentë të nxjerrë vendim për rrënimin e objektit (por, sipas kërkesës këtë vendim bashkërisht e marrin inspektori i ndërtimit dhe drejtori i*

Inspektoratit), sepse kjo bie ndesh me mbrojtjen e të dënuarit i cili decidivisht ka deklaruar se kjo ka qenë kompetencë e inspektorit të ndërtimit”.

25. Në arsyetimin e pjesës së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme që ka të bëjë me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për ngritjen e aktakuzës pas afatit, Gjykata Supreme thekson se, *“Sa i përket pretendimit të fundit për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ka të bëjë me vonesën në ngritjen e aktakuzës, e njëjta mund të paraqiste shkelje relative të dispozitave të procedurës penale nga neni 384. par. 2. të KPPK-së, por Gjykata Supreme nuk e mori në konsideratë sepse kemi të bëjmë me një çështje e cila ka përfunduar në shkallën e parë dhe të dytë dhe tani nuk ka mundësi ligjore që të atakohet me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik”.*

Pretendimet e parashtruesit

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e kontestuara të gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 3 dhe nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së

27. Sa i përket neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNj-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se këto nene janë shkelur për shkak se aktakuza në rastin e tij është ngritur në mënyrë të kundërligjshme, gjegjësisht pas skadimit të afatit ligjor prej dy (2) viteve, edhe pse ky afat kohor është paraparë me ligj dhe Gjykata Supreme kishte dhënë mendimin e saj juridik në lidhje me çështjen e afatit kohor për ngritjen e aktakuzës.
28. Në lidhje me çështjen e afatit për ngritjen e aktakuzës, parashtruesi i kërkesës më tej thekson:

“Në të gjitha instancat ankimore si dhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë është ngritur çështja e aktakuzës së paligjshme e depozituar në Gjykata nga ana e prokurorit të rastit dhe se kjo çështje nuk është adresuar asnjëherë në asnjë nga instancat gjyqësore duke anashkaluar tërësisht trajtimin e çështjes dhe duke i mohuar me këtë trajtim të barabartë dhe barazi para ligjit, gjersa kjo paraqet gjithashtu devijim nga rregulli se aktakuzat e paligjshme ose të paafatshme janë hedhur poshtë si të palejuara në të gjitha rastet tjera”.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike

29. Sa i përket shkeljeve të lartcekura, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe karakterizuar në mënyrë të gabuar kompetencat e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht ai konsideron se për shkak të situatës karakteristike në të cilën ndodhej nuk ishte kompetent për të ndërmarrë veprime dhe se për shkak të mosndërmarrjes së tyre gjykatat e rregullta e kishin shpallur fajtor.
30. Parashtruesi i kërkesës për çështjen e zbatimit të gabuar të ligjit dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike më tej thekson se, *“Gjykata në mënyrë të gabuar ka konkluduar kompetencën e të mbrojturit tim pasi që ligjërisht ai nuk ka pasur kompetencë ligjore për të ndërmarrë veprimet të cilat i konsideron gjykata se nuk i ka ndërmarrë”.*

31. Në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se, “Në rastin konkret, shkelja e ligjit penal shprehet në faktin se ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale. Sipas ligjit për shërbyes civilë Nr. 03/L-149, neni 30, pika 4, i cili përcakton se ushtruesi i detyrës mundet të caktohet në afatin kohor prej 90 ditëve dhe në rastin e të mbrojturit tim ai është caktuar si ushtrues detyre nga data 18.04.2013 deri më 18.07.2013 dhe këtu edhe i ka skaduar mandati, do të thotë më tutje nuk ka pasur të drejtë ligjore, funksionale e as legjitimitet për të nxjerrë aktvendim për rrënim, siç është konstatuar nga prokuroria, i cili konstatim është nxjerrë në drejtim të amnistimit të bashkëpandehurve dhe më tutje në bartjen e përgjegjësisë tek i mbrojturi im për të nxjerrë një përgjegjësi tek ndokush. [...] aktgjykimi i ankimuar përfshihet gjithashtu në shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të KPK-së, më tutje neni 370, paragrafi 7, i cili shprehimisht kërkon që gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërtënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike”.
32. Parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që kërkesën e tij ta deklarojë të pranueshme, të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe të kthen të njëjtin në rivendosje, duke obliguar gjykatën të shqyrtojë ligjshmërinë e aktakuzës e cila është sjellë në mënyrë të kundërligjshme pas afatit ligjor.

Dispozitat relevante ligjore

**LIGJI NR. 03/L – 149
PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
i 13 majit 2010**

“[...]”

Neni 30

Zëvendësimi i nëpunësit civil në rast të mungesës

1. *Nëpunësit civilë, me urdhër nga eprori, janë të detyruar që përkohësisht ta zëvendësojnë një koleg i cili mungon ose ta plotësojnë një vend të lirë të punës, nëse veprimtaria e zakonshme e institucionit do të pengohet nga mungesa e nëpunësit civil.*
2. *Në rast të mungesës së një sekretari të përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent, ai/ajo do të zëvendësohet nga nëpunësi civil i rangut më të lartë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin për procedurën administrative.*
3. *Refuzimi për zëvendësimin e një nëpunësi civil, që mungon në raste emergjente, konsiderohet pengim i veprimtarisë administrative dhe iu nënshtrohet masave disiplinore.*
4. *Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.*

**KODI NR. 04/L-123
I PROCEDURËS PENALE**

i 13 dhjetorit 2012

“[...]”

Neni 3

Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe in dubio pro reo

1. Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës
2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

“[...]”

Neni 159

Afatet kohore të hetimit

1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme.
3. Nëse i pandehuri është arrestuar dhe mbahet në paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake nuk urdhëron vazhdimin nga paragrafi 2. të këtij neni apo vazhdimin e paraburgimit përveç nëse Prokurori i Shtetit tregon se hetimi po zbatohet në mënyrë aktive dhe vonesat janë jashtë kontrollit të tij.

“[...]”

Neni 250

Kërkesa për hedhjen e aktakuzës

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:
 - 1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
 - 1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
 - 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
 - 1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.
2. Prokurorit të shtetit duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj kërkesës gojarisht apo me shkrim.

3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hedh aktakuzën.

4. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

[...]

Neni 384

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

1.1 përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjyimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;

1.2 në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;

1.3 shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;

1.4 publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;

1.5 gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;

1.6 aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes;

1.7 gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;

1.8 aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

1.9 i akuzuari i thirrur të deklarohej mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave;

1.10 aktgjykimi ka tejkalluar akuzën;

1.11 me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të këtij Kodi; ose

1.12 aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi.

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2.1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose

2.2. kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjyimit të ligjshëm dhe të drejtë.

[...]

Neni 418

Mjetet e jashtëzakonshme juridike

[...]

3. Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Pala paraqet kërkesën në gjykatën themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme Gjykatës Supreme.

[...]

Neni 433
Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë

[...]

2. Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalia e fundit e këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të Gjykatës Themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.

[...].”

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 236/2020, të 10 nëntorit 2021, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

37. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GjEDNj) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih, gjithashtu, rastin [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

39. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës, nr. 17621/91*, kategoria (i), dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës, nr. 4241/03*, kategoria (iii)), shih, gjithashtu, rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 38).

40. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28, si dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 39).

41. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara (i) me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6 të KEDNj-së, si dhe (ii) me nenin 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës. Në vijim, Gjykata do t'i shqyrtojë veç e veç këto pretendime të parashtruesit të kërkesës.

(i) Për sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së

42. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, kanë të bëjnë me (a) faktin se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, përkatësisht kanë interpretuar dhe karakterizuar gabimisht kompetencat e parashtruesit të kërkesës sepse ai, duke pasur parasysh situatën karakteristike në të cilën ndodhej, nuk ka qenë kompetent për ndërmarrjen e veprimeve dhe se për shkak të mosndërmarrjes së tyre gjykatat e rregullta nuk kanë mundur ta shpallin fajtor, dhe (b) faktin se në rastin e tij procedura penale pranë Gjykatës Themelore është iniciuar në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht pas skadimit të afatit ligjor prej dy (2) viteve për ngritjen e aktakuzës. Kjo shkelje procedurale nuk është evituar as nga Gjykata e Apelit e as nga Gjykata Supreme. Në fakt, Gjykata Supreme edhe pse ka konstatuar se ka ndodhur një shkelje e tillë procedurale, ka theksuar se kjo nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

43. Lidhur me këtë, Gjykata, fillimisht, rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (shih, në këtë drejtim, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; [KI62/19](#), parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; [KI110/19](#), parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

(a) Për sa i përket pretendimeve se gjykatat gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike, përkatësisht kanë interpretuar ligjin në mënyrë të gabuar

44. Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike ose ligjore (ligjshmëria) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme ose nga një gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç në masën që ato gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata më tej rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, në këtë drejtim, rastin e GjEDNj-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 30544/96 Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës [KI128/18](#), cituar më lart, paragrafi 56; dhe [KI62/19](#), cituar më lart, paragrafi 58).

45. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të duhur dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin [Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991, dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës [K110/19](#), cituar më lart, paragrafi 41).

(b) Për sa i përket pretendimeve se procedura është iniciuar dy (2) vite pas ngritjes së aktakuzës.

46. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me faktin se në rastin e tij procedura penale pranë Gjykatës Themelore është iniciuar në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht pas skadimit të afatit ligjor prej dy (2) viteve për ngritjen e aktakuzës, Gjykata Supreme theksoi se:

“Sa i përket pretendimit të fundit për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ka të bëjë me vonesën në ngritjen e aktakuzës, e njëjta mund të paraqiste shkelje relative e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 2 të KPPK-së, por Gjykata Supreme nuk e mori në konsideratë sepse kemi të bëjmë me një çështje e cila ka përfunduar në shkallën e parë dhe të dytë dhe tani nuk ka mundësi ligjore që të atakohet me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik”.

47. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se nga këto argumente të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, në raste të tilla, parashtruesi i kërkesës ka mundur t'i ngre këto argumente para Gjykatës Themelore e jo para Gjykatës Supreme, përkatësisht në procedurë të jashtëzakonshme. Prandaj, Gjykata Supreme i shqyrtoi këto pretendime dhe deklaroi se pretendimet e tilla të parashtruesit të kërkesës ishin të pabazuara.
48. Siç edhe mund të konstatohet nga arsyetimi i Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës është dashur t'i iniciojë këto pretendime në Gjykatën Themelore brenda afatit të paraparë me nenin 250 të KPPK-së. Pasi që parashtruesi nuk ka vepruar në përputhje me normat ligjore, Gjykata Supreme nuk është marrë me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës.
49. Sa i përket këtij pretendimi, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kjo çështje është ngritur gjatë procedurave në Gjykatën e Themelore, respektivisht para shqyrtimit të dytë, përmes kërkesës për hedhjen e aktakuzës, siç parashihet me nenin 250 të KPPK-së. Gjithashtu, Gjykata vëren se nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës ka ngritur këtë çështje para gjykatave të rregullta pas afatit të përcaktuar me nenin 250 të KPPK-së. Para Gjykatës Supreme parashtruesi i kërkesës e ka përsëritur këtë pretendim edhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ndaj këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme u përgjigj se ishte përgjegjësi e parashtruesit për t'i ngritur këto pretendime në afatin e parashikuar me KPPK-në. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar në përputhje me normat ligjore, Gjykata Supreme nuk është marrë me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, lidhur me kriteret e shterimit të mjeteve juridike në kuptimin thelbësor.
50. Gjykata fillimisht thekson se përderisa në kontekstin e mekanizmit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli i shterimit të mjeteve juridike duhet të zbatohet me një shkallë të caktuar fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar, ky rregull kërkon në parim që ankesat dhe pretendimet që synohen të ngrihen më pas në procedurat gjyqësore, ato gjithashtu duhet të paraqiten para gjykatave të rregullta, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet formale të përcaktuara nga ligji në fuqi

(shih, rastin e GJEDNJ-së *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat 2478/15 dhe 1787/15, të 16 korrikut 2015, paragrafi 89 dhe referencat në të).

51. Më konkretisht, GJEDNJ është e mendimit se nëse ekziston një mjet juridik që u lejon gjykatave të rregullta, të paktën në thelb, të vendosin për një argument për shkeljen e një të drejte të caktuar, atëherë ai mjet juridik duhet të përdoret. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është paraqitur shprehimisht ose në thelb para gjykatave të rregullta, kur ajo ka mundur të paraqitet me rastin e përdorimit të një mjeti të caktuar juridik në dispozicion të parashtruesit, atëherë gjykatat të rregullta privohen nga mundësia për të vendosur për çështjen, si një mundësi që rregulli i shterimit të mjeteve juridike mundohet të ofrojë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat në të).
52. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike përmban dy elemente: (i) shterimin në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik kundër aktit të një autoriteti publik në një shkallë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimi i mjeteve në kuptimin thelbësor, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "thelb" para gjykatave të rregullta, në mënyrë që ato të kenë mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë shkeljen e të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron mjetet juridike të shterura vetëm kur parashtruesit, në pajtim me ligjet në fuqi, i kanë përdorur ato në të dy kuptimet (shih edhe lëndën e Gjykatës Kushtetuese [KI71/18](#), parashtruesit *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, aktvendimi për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafi 57).
53. Duke pasur parasysh këto parime dhe rrethanat në të cilat, në bazë të shkresave të rastit, rezulton se ky pretendim konkret i parashtruesit të kërkesës është paraqitur për herë të parë në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme, ajo konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk iu ka ofruar mundësi gjykatave të rregullta, gjegjësisht Gjykatës Themelore, që ta shqyrtojnë këtë pretendim dhe në këtë mënyrë të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i paraqet drejtpërdrejt para kësaj Gjykate, para se ai të ketë shterur mjetet juridike, në kuptimin e tyre thelbësor (shih, *mutatis mutandis*, lënda e Gjykatës Kushtetuese [KI118/15](#), parashtruesi i kërkesës *Dragiša Stojković*, aktvendimi për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-36).
54. Si rezultat, lidhur me këtë pretendim, gjegjësisht pretendimin për afatin kohor për ngritjen e aktakuzës, Gjykata konstaton se duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mos shterjes së të gjitha mjeteve juridike në kuptimin thelbësor, siç kërkohet nga pika (b) paragrafi (1) i rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Për sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës

55. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit në lidhje me shkeljen e nenit 3 [Barazia para ligjit] dhe nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, Gjykata thekson se nenet e lartpërmendura 3 dhe 7 bien nën Kapitullin I [Dispozitat Themelore] të Kushtetutës, të cilat nuk mund të vlerësohen në kuadër të kësaj ankese kushtetuese. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata arrin në përfundimin se nuk do të merret me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës.

56. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (ii) së pretendimeve të cilat kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*. Rrjedhimisht, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

57. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së në lidhje me afatin kohor për ngritjen e aktakuzës, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës cilësohen si pretendime të papranueshme në baza procedurale për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në kuptimin thelbësor siç kërkohet nga pika (b) e paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtave të garantuara nga nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, Gjykata thekson se këto nene të Kushtetutës bien nën Kapitullin I [Dispozitat Themelore] të Kushtetutës, të cilët nuk mund të vlerësohen në kuadër të fushëveprimit të kësaj ankese kushtetuese. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata arrin në përfundimin se nuk do të merret me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës pasi që ai bie nën kategorinë (ii) e pretendimeve të cilat kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafët (1) (b) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, më 27 tetor 2022, me shumicë:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

